

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë, gjyqtarja e vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Shkodra, në lëndën penale kundër të pandehurëve: D.M. nga ...., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së të cilin e përfaqësonte sipas autorizimit av. ... nga ..., I.M. nga ....., për shkak të tri veprave penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, N.R. nga ....., K. e Kamenicës, për shkak të dy veprave penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, G.M. nga ..., K. e Kamenicës, për shkak të dy veprave penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, M.M. nga ..., K. e Kamenicës, për shkak të veprës penale blerja, pranimit ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 parag. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës PP.II.nr.813/2014 i dt. 03.07.2014, si dhe propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri PP.II.nr.813/2014 të datës 06.09.2017, më datë 21.12.2017, në prani të Prokurorit të Shtetit Esat Ademi dhe të akuzuarëve, D.M, mbrojtësit me autorizim av....., I.M., G.M., M.M, komunikoi publikisht, ndërsa më datën 15.01.2018 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

Të pandehurit :

1.D.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati, i lindur më ,, dat lindja,, në ..., me vendbanim në ....”, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, sipas evidencës që disponon kjo gjykatë i dënuar më parë për vepër penale .

2.I.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati i lindur më ,,dat lindja,, në ... e Kamenicë, tani me vendbanim në ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në bazë të evidencës që disponon gjykata i dënuar më parë për vepër penale.

3.G.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati, i lindur më ,, dat lindja,, në Kamenicë, tani me vendbanim në....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë ka qenë i dënuar më parë për vepër penale.

4.M.M., pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati, i lindur më ,, dat lindja, në ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, në bazë të evidencës që disponon kjo gjykatë nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër penale.

### **Ndaj të pandehurit D.M.,**

Konform nenit 514 parag. 1 të KPPRK-së,

Hudhet propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri PP.II.nr.813/2014 të dt. 06.09.2017 si e pa bazuar dhe pushohet procedura penale ndaj të pandehurit D.M., meqë nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitivin I.

#### **I.**

Ndërmjet datave 06.03.2014-14.03.2014, në kohë të pa përcaktuar, në ....., K. e Kamenicës, të pandehurit , me qëllim që vetes ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror, kanë kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarve H.D. dhe I.D., në atë mënyrë që kanë hyrë në pronën e të dëmtuarëve dhe nga aty kanë marr dy koshere me bletë, në këtë mënyrë të dëmtuarëve iu kanë shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

-meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari I.D. nga fshati ....., për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **I pandehuri, I.M.,**

Në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 i KPPRK-së,

Lirohet nga akuzat

#### **I.**

Ndërmjet datave 06.03.2014-14.03.2014, në kohë të pa përcaktuar, në fshatin ....., K. e Kamenicës, të pandehurit, me qëllim që vetes ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasurore, kanë kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarve H.D. dhe I.D., në atë mënyrë që kanë hyrë në pronën e të dëmtuarëve dhe nga aty kanë marr dy koshere me bletë, në këtë mënyrë të dëmtuarëve iu kanë shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

-meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

## **II.**

Më datën 15.03.2014, në kohë të pa përcaktuar, në ....., në vendin “ ....” , i pandehuri G.M. me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, kanë kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarit F.M., në atë mënyrë që kanë hyrë në pronën e të dëmtuarit dhe nga aty kanë marr pesë koshere me bletë, ku me veturën e tij i pandehuri G. i ka dërguar te shtëpia e të pandehurit I.M., në këtë mënyrë të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

-meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari I.D. nga fshati ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil .

I dëmtuari F.M. nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **I pandehuri, G.M.,**

Është fajtor

## **II.**

Më datën 15.03.2014, në kohë të pa përcaktuar, në ....., në vendin “ ....” , i pandehuri G.M me qëllim që vetit ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarit F.M., në atë mënyrë që ka hyrë në pronën e të dëmtuarit dhe nga aty ka marr dy koshere me bletë, të cilat me veturën e tij i pandehuri G. i ka dërguar në emër të një borxhi te shtëpia e të pandehurit I.M., në këtë mënyrë të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 41,46, 50,51,52, 73,75, të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin ,

E G j y k o n

-me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej 200 €, të cilën shumë ka për ta paguar duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit apo në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

-dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve, ekzekutimi i të cilit dënim nuk do të bëhet nëse i akuzuari brenda afatit prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale, në rast se i akuzuari kryen veprë tjetër penale, brenda afatit të verifikimit atëherë dënimi me kusht ka për t'iu revokuar në dënim me burg.

I dëmtuari Fatmir Maliqi nuk parashtrroi kërkesë pasurore juridike .

Detyrohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

**Të pandehurit: G.M. e I.M.,**

Në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 i KPPRK-së,

Lirohen nga akuza

### **III.**

Në mes datave 19-21.2014, në kohë të pa përcaktuar, në fshatin ....., të pandehurit me qëllim që vetit ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror, kanë kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarit A.K., në atë mënyrë që kanë hyrë në pronën e të dëmtuarit dhe nga aty kanë marr tri koshere me bletë, ku me veturën e tij i pandehuri i ka dërguar te shtëpia e të pandehurit N.F., në këtë mënyrë të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm në vlerë të pa përcaktuar.

-meqë nuk është provuar se kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I dëmtuari A.K., nga ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

**I pandehuri, M.M.,**

Në pajtim të nenit 364 parag. 1 nën parag. 1.3 i KPPRK-së,  
Lirohet nga akuza

#### **IV.**

Më datën 18.03.2014, rreth orës 06.00, në fshatin ....., i pandehuri M.M., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, ka blerë pesë koshere bletë, si në dispozitivin II, të kësaj akuze, nga i pandehuri I.M. në vlerë prej 300 € dhe në bazë të çmimit dhe vlerës së tyre e ka ditur se të njëjtat janë përfituar me anë të kryerjes së veprës penale të vjedhjes, në këtë mënyrë të dëmtuarit F.M. i kanë shkaktuar dëme materiale në vlerë të pa përcaktuar.

**-meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 parag.1 të KPRK-së.**

I dëmtuari F.M. nuk parashtroi kërkesë pasurore juridike

Shpenzimet e procedurës penale bien në ngarkesë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.813/2014 datës 03.07.2014, si dhe propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri të datës 06.09.2017, si në hyrje të aktgjykimit, ka akuzuar D.M. nga ....., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së të cilin e përfaqësonte sipas autorizimit av. .... nga ..., I.M. nga fshati ..., për shkak të tri veprave penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me neni 31 të KPRK-së, N.F. nga fshati ..., G.M. nga fshati ....., për shkak të dy veprave penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, M.M. nga fshati ..., për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 parag. 1 të KPRK-së, pranë të cilës ka mbetur edhe në fjalën përfundimtare me propozim që të pandehurit D.M. t'i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, ndërsa të pandehurit të tjerë të deklarohen fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

**Gjykata konform nenit 36 të KPPRK-së bënë veçimin e procedurës penale për të pandehurin N.F., pasi i njëjti është i pa kapshëm për gjykatën, ashtu që procedura penale për të njëjtin do të zhvillohet dhe do të përfundohet ndaras.**

Prokuroria e shtetit gjatë shqyrtimeve gjyqësore e pas mendimit të konsiliumit në përbërje prej tre doktorëve psikiatër, për të pandehurin D.M. bëri ndryshimin e aktit akuzës edhe ate nga aktakuza, propozoi që të njëjtit t'i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri, për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuari D.M. ne prezencë te mbrojtësit të tij Av. .... në tërsi kontestoj faktin se së bashku me I.M e N.F. të kenë vjedhur bletë te H.e I.D., ndërsa nuk konteston faktin se dy bletë ja ka shitur H.B. për te cilin rast është gjykuar në gjykatën e Novobërdës.

Në fjalën përfundimtare mbrojtësi i D.M., Av.... deklaroi se aktakuza nuk është mbështet me asnjë provë për tu vërtetuar se D.M. ka kryer veprën penale si ne aktakuzë pasi qe provat e shtjelluara ne shqyrtimin gjyqësor janë irelevante, te papranueshme për te nxjerr një konstatim objektiv se i akuzuari D.M. është akter i veprimeve inkriminuese qe ia vë në barrë organi i akuzës.

I akuzuari I.D. në mbrojtjen e tij në tërësi ka kontestuar faktin se, së bashku me D.M. e N.F. të ketë kryer vjedhje në ....., H. e I.D. dhe as që ka njohuri se kush e ka kryer këtë veprë penale të vjedhjes të përshkruar në pikën **I.** të aktakuzës. Ndërsa sa i përket veprës penale të përshkruar në pikën **II.** të aktakuzës, konteston në tërësi që së bashku me G.M. të ketë vjedhur bletë tek i dëmtuari F.M., mirëpo nuk konteston faktin se nga G. ka blerë katër koshere të bletëve në shumë prej nga 65 €, të cilat koshere bletësh i ka marr në emër të një borgji, gjithashtu nuk konteston se këto koshere bletësh ia ka shitur M.M. të cilat së bashku me G. ia ka dërguar M.M. të cilin e ka njohur më herët dhe gjatë bisedës me te është njoftuar se i njëjti ka shprehë dëshirë të merret me bletari, e atëherë kur G.ia ka ofruar kosheret e bletëve ia ka dërguar M. pasi që i njëjti ka shprehë interesim të blejë bletë, po ashtu sa i përket veprës penale si në pikën **III.** të kësaj aktakuze në tërësi konteston faktin se së bashku me G. e N. të kenë shkuar në fshatin Qarakovc për të vjedhur bletë duke shtuar se për këtë fshat ka dëgjuar për herë të parë.

Në fjalën përfundimtare nuk e ndien veten fajtor për kryerjen e këtyre veprave penale duke kërkuar nga gjykata që pas shqyrtimit të të gjitha provave në mënyrë sa më të drejtë ta liroi nga përgjegjësia penale, pasi që aktakuza nuk është e mbështetur në asnjë provë.

I akuzuari G.M. në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin, se si në pikën **II.** të aktakuzës te i dëmtuari F.M. ka vjedhur dy koshere bletësh të cilat i ka vjedhur vetë në një mbrëmje, për të cilat koshere bletësh i ka thënë I.M. se i ka siguruar te dajhtë e tij, këto bletë I.ia ka dhënë në emër të një borxhi, së bashku me I. këto bletë i ka dërguar te M.M., e sa i përket marrëveshjes së tyre nuk ka njohuri, ndërsa sa i përket pikës **III.** në tërësi e konteston faktin të ketë qenë i implikuar dhe as që ka njohuri për këtë rast.

Në fjalën e tij përfundimtare, i njëjti thekson se, e ndien vetën fajtor për vjedhjen e dy koshereve të bletëve të vjedhura si në pikën **II.** tek i dëmtuari F.M., ndërsa nuk e ndien veten fajtor edhe për tri koshere bletësh të vjedhura tek i njëjti i dëmtuar, gjithashtu nuk e ndien vetën fajtor për veprën penale të përshkruar si në pikën **III.** të kësaj aktakuze dhe kërkon nga gjykata që pas shqyrtimit të të gjitha provave t'i vlerësojë sa ma drejtë dhe ta liroj nga përgjegjësia penale për veprën penale të përshkruar si në pikën **III.** të kësaj aktakuze, pasi vepra penale në disp.III. nuk mbështetet në asnjë provë, ndërsa sa i përket dispozitivit **II.** kërkon nga gjykata t'i shqiptoj një dënim sa më të butë pasi është shfrytëzues i ndihmave sociale.

I akuzuari M.M. në mbrojtjen e tij nuk e ka kontestuar faktin, se ka blerë katër koshere të bletëve nga I.M. e të cilat koshere i ka pranuar në emër të një borgji, të njëjtit i ka shitur kafshë, për të cilat I. i ka mbetur borgj në shumë prej 480 €, ndërsa katër koshere të bletëve i ka blerë në çmim prej 300 €, I.M. e njeh si tregtar, për çka edhe nuk ka pasur njohuri se bletët kanë qenë të vjedhura, pasi që çmimi i bletëve ka qenë çmimi i tregut, kosheret e bletëve ia kanë sjellur I.me G., e për të cilat bletë është njoftuar se I. i ka blerë

nga G., pas disa ditëve është njoftuar nga policia se bletët janë të vjedhura, të njëjtat janë konfiskuar dhe iu janë kthyer pronarëve,

Në fjalën e tij përfundimtare nuk e ndien veten fajtor dhe nuk pranon se e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi në asnjë mënyrë nuk e ka ditur se bletët të cilat i ka blerë kanë qenë të vjedhura, andaj kërkon nga gjykata që pas shqyrtimit të të gjitha provave sa më drejtë ta liroj nga përgjegjësia penale për veprën penale për të cilën është ngarkuar.

Gjykata në këtë çështje penalo juridike, ka proceduar provat e propozuara, ka dëgjuar të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarëve: I.D., F.M., A.K., ka lexuar deklaratën e të dëmtuarit – të ndjerit H.D. të dhënë në stacionin policor në ..... më dt. 14.03.2014, dëshmitarët: B.B., R.K., R.TH., J.B, B.K, F.S., si dhe ka bërë shtjellimin e provave materiale bashkangjitur lëndës si: vërtetimi mbi kthimin e mallit – sendeve me nr. 2014-CB-128, e dt. 19.03.2014, vërtetimi mbi konfiskimin e mallit me numër dhe datë të njëjtë, vlerësimin e konsiliumit të doktorëve në emër të D.M. si dhe është shikuar foto dokumentacioni bashkangjitur lëndës.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit **I.D.** në dëshminë e tij deklaroi se në vitin 2014, iu është vjedhur një koshere bletësh në fsh. .... dhe një koshere bletësh tjetër të ndjerit H.D., *nuk ka dyshuar në askënd*, nuk kanë gjetur gjurmë dhe nuk janë gjetur asnjëherë bletët e vjedhura, rasti është lajmëruar në polici së bashku me policët *kanë shkuar në fsh. ....* pas daljes në vend të ngjarjes kanë parë disa bletë te një person në këtë fshat, *mirëpo pas shikimit të tyre nuk ka rezultuar se ndonjëra nga bletët të jetë e tij apo e të ndjerit H.*

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit **A.K.** në dëshminë e tij deklaroi: në vitin 2014 iu janë vjedhur tri bletë të cilat kanë qenë të vendosura në dalje të fsh. ...., ditën konkrete ka vërejtur se i mungojnë tri koshere bletësh, *nuk ka dyshuar në askënd*, rastin e ka lajmëruar në polici, gjurmë nuk ka pasur, kosheret e *bletëve deri më tani nuk janë gjetur*, së bashku me zyrtarët policor ka qenë në fsh. ... te një person që ka mbajtur bletë, mirëpo nuk ka rezultuar që aty të jenë edhe bletët e tij.

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit **F.M.** në dëshminë e tij deklaroi: në vitin 2014 iu janë vjedhur pesë shoqëri bletësh, mirëpo të njëjtat *nuk janë vjedhur të njëjtën ditë por për një periudhë kohore prej 10 ditësh*, ditën konkrete ka vërejtur se i mungon edhe një bletë për qka dhe ka lajmëruar policinë diku pas orës 21.00 min, *fillimisht nuk ka dyshuar në askënd*, gjatë hetimeve së bashku me zyrtarët policor kanë shkuar për t'i identifikuar bletët tek personi M.M., në oborrin e të njëjtit kanë qenë të vendosura katër bletë, *dy prej tyre kanë qenë të tij*, ndërsa dy të tjera nuk kanë rezultuar të jenë bletë të tij, nga M. është



njoftuar se i njëjti sa i përket dy bletëve të tij i ka blerë nga I.M., *e për të cilat nuk ka pas njohuri se kanë qenë të vjedhura*, bletët tjera nuk iu janë kthyer asnjëherë.

Është lexuar deklarata e të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit tani i ndjerë H.D., nga e cila deklarata gjykata vërtetoi se më dt. 14.03.2014, i dëmtuari ka lajmëruar policinë se në ... i mungon një sanduk dy katesh i bletëve, nuk ka dyshuar në askënd.

Dëshmitari **B.B.** në dëshminë e tij deklaroi: se në vitin 2014 ka ruajtur disa zagat në shtëpinë e H.B. në ..., i cili punon në ..., nuk konteston se I. e ka thirr në telefon dhe e ka njoftuar se do ta bjen një zagat, I. në fsh. ... ka shkuar së bashku me D.M., të nesërmen ka shkuar në shtëpinë e H. dhe aty ka parë dy bletë të cilat ishin vendosur në tarracën e shtëpisë, për këtë ka kontaktuar me pronarin e shtëpisë i cili e ka njoftuar se i ka blerë dy koshere bletësh nga D.M. në shumë prej 100 €, të nesërmen D. me një person tjetër janë ardhur për t'ia ndërruar sandukët e bletëve, *ndërsa I. nuk ka qenë i përfshirë në rastin e bletëve*, më pas kanë ardhur policia e SP në ... për verifikimin e bletëve të cilat edhe i kanë mar, për çka menjëherë e ka njoftuar pronarin e shtëpisë H.B..

Dëshmitari **R.K.** në dëshminë e tij deklaroi: se në vitin 2014 ka blerë koshere të bletëve nga D.M., me të cilin janë marr vesh që t'ia sjell katër bletë në shumë prej nga 80 €, janë marr vesh që kur ta lajmërojnë atëherë do t'ia sjellë kosheret e bletëve, pas kësaj është takuar me N.F. dhe gjatë një bisede janë dakorduar kanë hyrë në marrëveshje që cili ka më shumë koshere të bletëve me ia shitë tjetrit, një koshere të bletëve do të shitet në shumë prej 130 €, kështu që kosheret e bletëve e blera nga D. ende pa i parë ia ka shitur N., kosheret e bletëve D. ia ka dërguar N., kosheret e bletëve i ka blerë në shumë prej nga 80 €, nga D. ndërsa N. ia ka shitur nga 130 €, derisa është intervistuar nga policia nuk ka pasë njohuri që këto bletë janë të vjedhura, për të njëjtat koshere të bletëve, për të njëjtin person ( të akuzuar) është deklaruar edhe në Gjykatën e Novobërdës.

Dëshmitarit **R.TH.** në dëshminë e tij deklaroi, se, në stacionin policor në Muqivërc, ankuesi H. D. ka raportuar se i është vjedhur një koshere e bletëve, janë dalur në vend të ngjarjes në ... me ankuesin, kanë konstatuar se vjedhja është kryer, në afërsi të bletëve të H., ka munguar edhe një koshere e bletëve në pronësi të I.D., rasti iu është dedikuar njësisë së hetimeve, *asnjëherë nuk ka marr informatë se janë zbuluar kryesit e kësaj veprë penale.*

Dëshmitari **J.B.** në dëshminë e tij deklaroi: njësitë i hetimeve në Kamenicë ka kryer hetime lidhur me vjedhjen e disa bletëve që kanë ndodhur në komunën e Kamenicës, të Novobërdës dhe Gjilanit, ka përpiluar një raport të përgjithshëm në bazë të hetimeve që janë bërë, ka intervistuar B.B., bletët të cilat janë lënë në .... *vetëm janë dyshuar se kanë qenë bletët e H. dhe I.D.*, dyshimi është mbështet për shkak se është përputhur data e raportimit të vjedhjes, më datën kur janë dërguar në fsh. ..., *mirëpo sa ka*

*informacion policia e Novobërdës i kanë sekuestruar të njëjtat, i kanë dërguar në Novobërdë dhe iu janë kthyer të dëmtuarve, sipas njohurive që ka personat e njëjtë d.m.th. D.M., I.M. e N.F. janë akuzuar për të njëjtën vepër dhe janë dënuar në Gjykatën e Novobërdës, për rastet tjera si në aktakuzë nuk ka qenë i ngarkuar dhe nuk ka njohuri .*

Dëshmitari **F.S.** në dëshminë e tij deklaroi: me sa i kujtohet rasti ka ndodhur diku në vitin 2014, kur i dëmtuari F.M. ka lajmëruar rastin e vjedhjes së pesë koshere të bletëve, kanë dalur në vendin e ngjarjes në ..., është intervistuar i dëmtuari, i cili ka identifikuar ngjyrën e koshereve të bletëve dhe sa i kujtohet dëmi i shkaktuar sipas të dëmtuarit kap shumë diku 600 €, për rastin nuk ka njohuri pasi vetëm ka dalë në vendin e ngjarjes, ka qenë mbrëmje dhe nuk kanë marr gjurmë, vendi ku kanë qenë të vendosura bletët ka qenë vend i hapur në natyrë, *i dëmtuari nuk ka dyshuar në askënd.*

Dëshmitari **B.K.** në dëshminë e tij deklaroi: gjatë hetimeve janë njoftuar se bletët e vjedhura të F.M. gjenden në ..., janë dalur në vend të ngjarjes dhe janë takuar me M.M., i njëjti i ka informuar se katër bletët të cilat i posedon i ka blerë nga personat, G.M. e I.M., në vlerë prej 300 €, *pas identifikimit të bletëve nga i dëmtuari F.M. kanë rezultuar se **dy koshere të bletëve janë koshere të bletët të dëmtuarit**, ndërsa dy bletë tjera kanë rezultuar të jenë koshere bletësh për një rast tjetër që është marr policia e Ranillukut*, M.M. ka qenë bashkëpunues, i njëjti merret me bujqësi dhe nuk ka qenë asnjëherë i ndeshur me ligjin, kosheret e bletëve janë blerë me çmim tregu (vlerë 300 €), nuk mundë të deklarohet se i akuzuari e ka ditur apo ka mundë ta dijë se këto bletë janë të vjedhura.

Nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike **të përshkruar si në dispozitivin I.** të këtij aktgjykimi nuk është provuar teza nga akuza e prokurorit të shtetit se të pandehurit, D.M., I.M., kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 Paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, *për arsye si në vijim:*

Në këtë çështje penale juridike vetëm një rrethanë nuk ka ngel në mëdyshje, fakti se të dëmtuarve H.e I.D. ju janë vjedhur dy koshere me bletë ndërmjet datave 06.03.2014-14.03.2014 në ..., mirëpo nuk u vërtetua se këto koshere të bletëve janë vjedhur nga D.M. e I.M.. Gjykata nga dëgjimi i të dëmtuarit I.D. dhe leximin e deklaratës së të ndjerit H.D. vërtetoi se të njëjtëve ju janë vjedhur dy koshere me bletë, për të cilat të dëmtuarit nuk kanë dyshuar në askend dhe kosheret e bletëve e vjedhura nuk ju janë kthyer deri më tani. Nga dëshmitari B.B. gjykata vërtetoi faktin se në shtëpinë e H.B., D.M. e I.M. i kanë dërguar dy koshere të bletëve dhe sipas H.B. i njëjti këto bletë i ka blerë nga D.M., e të cilat bletë *janë konfiskuar nga policia e stacionit policor në Novobërdë* (që nënkupton se kosheret e bletëve nuk kanë qenë të të dëmtuarve I. e H.D.). Sa i përket dëshmitarit R.TH. nga dëshmia e tij u vërtetua se i njëjti pas ndërmarrjes së veprimeve fillestare hetimore, rastin ia ka dedikuar njësisë së hetimeve dhe deri më tani nuk ka

informatë se janë zbuluar kryerësit e kësaj vepre penale. Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit J.B. *hetues në rastin konkret, gjykata vërtetoi se vetëm është dyshuar se kosheret e bletëve të vjedhura tek të dëmtuarit H. e I.D. janë vjedhur nga D.M., I.M., mirëpo sipas informacioneve që ka këto bletë për të cilat kanë dyshuar se janë të të dëmtuarëve janë sekuestruar nga policia e stacionit policor në Novobërdë e të cilat bletë ju janë kthyer të dëmtuarve, ( jo të dëmtuarve H. e I.D.), sipas këtij dëshmitarit të akuzuarit e lartpërmendur janë akuzuar dhe janë dënuar në gjykatën e Novobërdës për bletët e konfiskuara në shtëpin e H.B.*

Të gjitha provat e proceduara gjykata i ka vlerësuar me kujdes, çdo provë veç e veç dhe të tëra së bashku duke i vënë në korrelacion reciprok, si edhe në raport me mbrojtjen e të akuzuarve e në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës, Në bazë të një vlerësimi të këtyllë të kujdesshëm të të gjitha provave të proceduara, gjykata *me asnjë provë të vetme* nuk mundi të vërtetoi faktin se të akuzuarit kishin kryer veprën penale për të cilën ishin ngarkuar, i gjithë dyshimi për të iniciuar procedurë penale kundër të akuzuarve ishte një supozim, e kjo u vërtetua edhe nga hetuesi i rastit J.B. i cili deklaroi se për të iniciuar këtë procedurë kanë pasur vetëm *dyshim që d.t.th të thotë se nuk kanë pasur asnjë provë për të vërtetuar se të akuzuarit kanë qenë të implikuar në kryerjen e kësaj vepre penale*, gjithashtu duke marr parasysh se bletët e konfiskuara ju janë kthyer të dëmtuarve tjerë e jo si në aktakuzë.

Nga provat që janë proceduar në çështjen penalo-juridike **të përshkruar si në dispozitivin II.** të këtij aktgjykimi nuk është provuar teza nga akuza e prokurorit të shtetit se i akuzuari, I.M., ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 Paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nuk u vërtetua se i akuzuari G.M. ka vjedhur edhe tri koshere të bletëve ( meqë për dy koshere të vjedhura të bletëve i njëjti ka pranuar fajësinë ) tek i dëmtuari F.M., *për arsye si në vijim:*

Në këtë çështje penalo juridike nuk ka ngel në mëdyshje, fakti se të dëmtuarit F.M. ju janë vjedhur pesë koshere të bletëve *në një periudhë kohore prej 10 ditësh*, në muajin mars të vitit 2014 në ..., gjithashtu nuk është kontestuese se dy koshere bletësh i ka vjedhur G.M. i cili edhe pohoi këtë fakt, se personalisht ka vjedhur dy koshere të bletëve tek i dëmtuari pa ndihmën e askujt, gjë e cila është përshkruar edhe në pikën **II.** të këtij aktgjykimi, G.M. me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm ka vjedhur koshere të bletëve të cilat i ka dërguar tek i akuzuari I.M., e të cilat koshere të bletëve ( dy koshere të bletëve ) ia ka shitur I.M. në emër të një borxhi, të identifikuar nga i dëmtuari tek personi M.M..

Mirëpo nuk u vërtetua se edhe tri koshere të bletëve të cilat i kanë munguar të dëmtuarit ti ketë vjedhur G.M., gjë që nuk është vërtetuar se I.M. në bashkëveprim me G.M. ti kanë vjedhur pesë koshere të bletëve tek i dëmtuari F.M.. Gjykata nga dëgjimi i të dëmtuarit F.M. vërtetoi faktin se të njëjtit *për një periudhë kohore prej 10 ditësh ju janë vjedhur pesë koshere bletësh*, për çka nuk ka dyshuar në askënd, i

cili me zyrtarët policor kanë qenë te personi M.M. në oborrin e të cilit kanë qenë të vendosura katër koshere të bletëve, mirëpo vetëm dy prej tyre i ka identifikuar të jenë të tij dhe sa i përket tri koshere të bletëve tjera të njëjtat nuk iu janë k'thyer asnjëherë ( pra nga bletët të cilat i ka blerë M.M. vetëm dy kanë rezultuar të jenë të F.M.).

Sa i përket dëshmitarit F.S. nga dëshmia e tij u vërtetua se, i njëjti ka dalur në vend të ngjarjes, ka konstatuar vjedhjen dhe për rastin nuk ka njohuri tjera. Po ashtu edhe nga dëshmia e dëshmitarit B.K., hetues në rastin konkret, gjykata vërtetoi, se pas hetimeve të ndërmarra kanë dalur së bashku me të dëmtuarin në ... tek personi M.M. i cili ka poseduar katër koshere të bletëve dhe pas identifikimit të bletëve te i dëmtuari ka rezultuar se dy koshere të bletëve janë të të dëmtuarit F.M..

Të gjitha provat e proceduara gjykata i ka vlerësuar me kujdes, çdo provë veç e veç dhe të tëra së bashku duke i vënë në korrelacion reciprok, si edhe në raport me mbrojtjen e të akuzuarve në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës, Në bazë të një vlerësimi të këtillë të kujdesshëm të të gjitha provave të proceduara, gjykata me asnjë provë të vetme nuk mundi të vërtetoi faktin se, i akuzuari G.K. t'i ketë vjedhur edhe tri koshere të bletëve ashtu siç përshkruhet në pikën II. të aktakuzës, gjë që nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme se edhe i akuzuari I.M. të ketë qenë i implikuar në vjedhjen e pesë koshereve të bletëve te i dëmtuari F.M., faktin se M.M. i ka blerë katër koshere të bletëve nga I.M. në emër të një borxhi nuk u kontestua as nga i akuzuari M.M. e as nga të akuzuarit G.M. e I.M.. Për dy kosheret e bletëve të identifikuara nga i dëmtuari tek i akuzuari M.M., i akuzuari G.M. ka pranuar fajësinë dhe është deklaruar se këto *dy koshere ia ka shitur I.D. në emër të një borxhi.*

Gjykata në bazë të provave të procedura, vërtetoi se i akuzuari G.M. , ka vjedhur dy koshere të bletëve në dëm të të dëmtuarit F.M., me çka ka kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 parag. 1 të KPRK-së, të cilën gjë nuk e mohoi as i akuzuari në mbrojtjen e tij, andaj gjykata me rastin e vendosjes mbi llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ndaj të akuzuarit për veprën penale që e ka kryer, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 74 të KPRK-së, ndikojnë që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë, ashtu që gjykata si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori: se i njëjti nuk mohoi vjedhjen e dy koshereve të bletëve, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, premton se në të ardhmën nuk do të përsërisë vepër tjetër penale, gjendjënë varfër ekonomike-shfrytëzues i ndihmave sociale, i dëmturi nuk parashtrroi kërkesë pasurore juridike, ndërsa nuk gjeti rrethanë veçanërisht rënduese, andaj gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit me gjobë dhe dënimit të kushtëzuar do të arrihet qëllimi i dënimit ngase qëllimi i dënimit është që kryerësin ta parandaloj nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin – risocializimin e tij, andaj bazueshëm mund të pritët që ky dënim do të ndikoj pozitivisht në përmirësimin e të akuzuarit, do të ketë ndikim edukativ edhe ndaj qytetarëve tjerë që në të

ardhmen mos të kryejnë vepra penale, sikundër që do t'i kontribuojnë disiplinës dhe përgjegjësisë më të madhe të qytetarëve në përgjithësi.

Nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike **të përshkruar si në piken III.** të këtij aktgjykimi nuk është provuar teza nga akuza e prokurorit të shtetit se të akuzuarit, G.M. e I.M., kanë kryer veprën penale vjedhje nga neni 325 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, tek i dëmtuari A.K., *për arsye si në vijim:*

Në këtë çështje penale juridike nuk ka ngel në mëdyshje, fakti se të dëmtuarit A.K. ju janë vjedhur tri koshere të bletëve në muajin mars të vitit 2014, në ....., K. e Kamenicë.

Gjykata nga dëgjimi i të dëmtuarit A.K. vërtetoi faktin se të njëjtit në vitin 2014 ju janë vjedhur tri koshere bletësh, nuk ka dyshuar në askend, së bashku me zyrtarët policor ka qenë në fshatin ... tek një person për të identifikuar bletët e tij të vjedhura, mirëpo nuk ka rezultuar që të jenë bletët e tij, bletët deri më tani nuk ju janë k'thyer.

*Në rastin konkret nuk pati asnjë provë të vetme për të vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale e cila ju vehet në ngarkesë,!!! si në pikën III të këtij aktgjykimi .*

Gjithashtu edhe nga provat që janë proceduar në çështje penale juridike **të përshkruar si në piken IV.** të këtij aktgjykimi nuk është provuar teza nga akuza e prokurorit të shtetit se i akuzuari, M.M., ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprën penale nga neni 345 parag. 1 të KPRK-së, *për arsye si në vijim:*

Në këtë çështje penale juridike nuk ka ngel në mëdyshje, fakti se tek i akuzuari M.M. janë gjetur dhe janë konfiskuar dy koshere të bletëve të identifikuara nga i dëmtuari F.M., ndërsa kontestuese del fakti se edhe tri koshere të bletëve të vjedhura tek i dëmtuari F.M. janë gjetur tek i akuzuari M.M., nga fakti se i dëmtuari F.M. në dëshminë e tij ka deklaruar se tek i akuzuari M.M. ka identifikuar dy koshere të bletëve të cilat edhe u janë kthyer, gjithashtu kontestuese del të jetë fakti se i akuzuari a e ka ditë, apo ka mund të dijë se kosheret e bletëve janë të vjedhura .

Gjykata nga dëgjimi i dëshmitarit B.K. hetues në rastin konkret, vërtetoi faktin se nga katër koshere të bletëve të gjetura tek i akuzuari M.M. dy kanë rezultuar të jenë të të dëmtuarit F.M., dëshmitari nuk ka mund të deklarohet se i akuzuari e ka ditur apo ka mundur të dijë se këto bletë janë të vjedhura për faktin se bletët janë blerë me çmim tregu (300€) dhe sipas dëshmitarit B.K., i akuzuari M. këto bletë i ka marr në kompenzim të një borxhi . Në bazë të një vlerësimi të këtillë të kujdesshëm të të gjitha provave të proceduara, gjykata me asnjë provë të vetme nuk mundi të vërtetoi faktin se, i akuzuari M.M. ka kryer

veprën penale të cilën ia vë në ngarkesë organi i akuzës, pra të ketë ditur apo të ketë mundur të dijë se kosheret e bletëve të blera janë të vjedhura, kur të merret parasysh fakti se kosheret e bletëve janë blerë me çmim tregu, si dhe të akuzuarin I.M., i akuzuari M.M. e ka njohur si tregtar.

Të gjitha provat e proceduara gjykata i ka vlerësuar me kujdes, çdo provë veç e veç dhe të tëra së bashku duke i vënë në korrelacion reciprok, si edhe në raport me mbrojtjen e të akuzuarit në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-ës, Në bazë të një vlerësimi të këtillë të kujdesshëm të të gjitha provave të proqeduara, gjykata me asnjë provë nuk mundi të vërtetoi faktin se të akuzuarit që janë liruar nga akuzat, kishin kryer veprat penale për të cilat ishin ngarkuar, i gjithë dyshimi për të inicuar procedurë penale kundër të akuzuarve ishte një supozim, (*sipas deklaratave të marra në fazën hetimore kemi të bëjmë me raste tjera e jo si në aktakuzë, e të bashkangjitura kësaj aktakuze*), sipas dispozitave të KPPRK-ës, përgjegjësia penale duhet të vërtetohet në mënyrë bindëse, pra në rastet konkrete nuk është vërtetuar e njëjta, askush nuk mund të shpallet fajtor në bazë të supozimeve pa pasur prova të drejtëpërdrejta të cilat do ta përshkruanin me saktësi ekzistimin e fakteve përkitazi me kryerjen e veprës penale, barra e administrimit të provave për t'u konstatuar fajësia bie në përfaqësuesin e akuzës, sipas parimit të së drejtës penale nuk ka vepër penale dhe nuk ka dënim pa faj "Nullum crimen nulla poena sine culpa". Gjithashtu në të drejtën penale vlenë parimi "Indubio Pro Reo", pra mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij në mbështetje të nenit 3 parag. 2 të KPPRK-së.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështeti në dispozitat e nenit 453 lidhur me nenin 450 dhe 454 parag. 1 të KPPRK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN-DEGA NE KAMENICE,

P.nr.220/2014, më datën 15.01.2018.

Sekretarja juridike,

\_\_\_\_\_  
Emine Shkodra,d.v.

Gj y q t a r j a,

\_\_\_\_\_  
Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej  
15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së  
Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.